

VENDIM
Nr. 1093, datë 24.12.2020

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘HIDROCENTRALI I BANJËS – GRAMSH DHE URA E
TRASHOVICËS’” (SHITESAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor ‘Hidrocentrali i Banjës – Gramsh dhe Ura e Trashovicës’” (shitesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “arë”, me vlerë 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, të përballohet nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., të kryejë likuidimin e detyrimeve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5 dhe 7, menjëherë pas miratimit të këtij vendimi.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në projekt.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Zyra Vendore Gramsh, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “HIDROCENTRALI I BANJËS – GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS” (SHITESAT)

Çmimi për pasurinë tokë “arë” sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	N/pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Asllan Ramazan Çarçiu	1556	40	Tokë “arë”	m ²	500	174	87,000	Konfirmuar nga ASHK-ja.
Shuma totale e shpronësimit						500		87,000	